

**VENDIM**  
**Nr. 694, datë 2.10.2019**

**PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 686, DATË  
22.11.2017, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E  
RREGULLORES SË PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “b”, të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në tekstin e rregullores së planifikimit të territorit, bashkëlidhur vendimit nr. 686, datë 22.11.2017, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen shtesat dhe ndryshimet, si më poshtë vijojnë:

Neni 1

Në nenin 2, pas pikës 15, shtohet pika 15/1 me këtë përmbajtje:

“15/1 “Konsolidim urban”, është procesi i densifikimit dhe i mbushjes urbane të njësisë strukturore apo të një a më shumë pjesëve të saj, të cilat janë të zhvilluara në mënyrë homogjene, sa u përket kushteve të zhvillimit, ndërtimeve në territor, si dhe rrjetit rrugor e infrastrukturor.”.

Neni 2

Pika 1 e nenit 11, ndryshohet si më poshtë vijon:

“1. Rishikimi i dokumentit të planifikimit kryhet në përputhje me nenin 26, të ligjit, për shkak të forcave madhore, si: tërmete, përmytje, zjarre masive, rrëshqitje të tokës, erozion etj., të ngjashme, për shkak të ndarjeve administrative e territoriale, ndryshimeve të paparashikuara demografike, sociale e ekonomike, ndryshimeve të shkaktuara nga kriza sektoriale, si edhe kur lind nevoja e harmonizimit me dokumente të një niveli më të lartë planifikimi apo me ndryshime të kuadrit ligjor në fushën e mbrojtjes e të menaxhimit të territorit, si dhe për arsye të përafritimit me legjislacionin e Bashkimit Evropian.”.

Neni 3

Pika 1, e nenit 22, ndryshohet si më poshtë vijon:

“1. Planet kombëtare sektoriale hartohen nga ministritë, me qëllim zhvillimin strategjik të një ose më shumë sektorëve, sipas fushave të kompetencës, si:

- a) siguria kombëtare;
- b) mbrojtja nga fatkeqësitë natyrore, të lidhura me: sizmicitetin, hidrogjeologjinë, hidrografinë, gjeologo-inxhinierinë, ndryshimet klimatike etj.;
- c) energjia;
- ç) industria;
- d) transporti;
- dh) infrastruktura;
- e) turizmi;
- ë) zonat detare dhe infrastruktura e ujit;
- f) zonat ekonomike;
- g) arsimit;

- gj) sporti;
- h) trashëgimia kulturore dhe natyrore;
- i) burimet natyrore;
- j) shëndetësia;
- k) bujqësia etj.”.

#### Neni 4

Shkronja “F”, e pikës 2, të nenit 82, ndryshohet si më poshtë vijon:

“f) zhvillimet në zonat e rrezikuara nga fatkeqësitë natyrore, tërmete, përmbytje, zjarre masive, rrëshqitje të tokës, erozion etj.”.

#### Neni 5

### **Hyrja në fuqi**

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTËR**  
**Edi Rama**